



UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

**PROGRAMI I LËNDËS**  
**Drejtimi: Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore**

**TITULLI I LËNDËS: ETNOLINGUISTIKA**

**Pedagogu:** Prof. Dr. Kristina Jorgaqi

**Ngarkesa:** 4 ECTS (30 orë leksione dhe 15 seminare)

**Lloji i lëndës:** lëndë me zgjedhje

**Programi i studimit:** Bachelor

**Viti/Semestri:** II/II

#### **EKSTRAKT**

Kjo lëndë është konceptuar enkas për studentët e arkeologjisë dhe të trashëgimisë kulturore si një ‘paketë’ informuese dhe formuese mbi çështje të përgjithshme, por edhe konkrete të gjuhës, të konsideruara si të nevojshme e të dobishme për formimin e tyre.

Studentëve iu ofrohet fillimisht një vështrim panoramik mbi rolin që ka luajtur gjuha si mjet komunikimi përgjatë periudhave të ndryshme të historisë njerëzore, duke u përqëndruar sidomos në shoqëritë evropiane nga Mesjeta e deri në krijimin e shteteve kombëtare. Më pas një vëmendje të posacme merr roli i gjuhës në kontekstin e shteteve kombëtare dhe gjuha kombëtare si pjesë shumë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore jomateriale të cdo populli. Jepet më tej një tablo e detajuar e mbrojtjes ligjore të gjuhës shqipe në Republikën e Shqipërisë.

Si vlerë kulturore jomateriale, por jo vetëm, shihet edhe entiteti i gjuhës standarde, i cili përfaqëson varietetin zyrtar të një gjuhe kombëtare. Historia e krijimit të shqipes standarde dhe realiteti që ajo përfaqëson, bëhen objekt shtjellimi të hollësishëm.

Për profesionistët që do të punojnë në fushën e trashëgimisë kulturore është cmuar si shumë e vlefshme dhënia e njohurive mbi faktorët që ndikojnë në procesin e vdekjes së gjuhëve, një fenomen ky gjithnjë e më i pranishëm në kontekstin e një bote të globalizuar. Shumë gjuhë ‘të vogla’ rrezikojnë sot të zhduken, por a mund të ndërhyhet dhe në c’forma mund të ndërhyhet nga shoqëria për t’i ruajtur ato? Elemente të antropologjisë gjuhësore, si raportet e gjuhës me etninë, me racën, me gjininë e sidomos me njohjen dhe kulturën, janë njohuri të tjera me vlerë që transmetohen përgjatë këtij kursi.

Në mënyrë relativisht të hollësishme diskutohen edhe çështje themelore të historisë së shqipes, si përkatësia indoevropiane dhe prejardhja e saj, vendi dhe koha e formimit të gjuhës shqipe, marrëdhëniet e shqipes dhe të paraardhëses së saj me gjuhë të tjera, emërtimi i shqipes përgjatë historisë etj., njohuri të nevojshme për formimin e profesionistëve të trashëgimisë kulturore.

**TEMAT:**

**LEKSION 1.** Roli i gjuhës si mjet komunikimi në shoqëritë evropiane nga Mesjeta e deri në krijimin e shteteve kombëtare

**LEKSION 2.** Roli i gjuhës në kontekstin e shteteve kombëtare

**LEKSION 3.** Gjuha kombëtare si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore jomateriale. Mbrojtja ligjore e saj në Republikën e Shqipërisë

**LEKSION 4.** Gjuha standarde si trajtë përfaqësuese dhe varietet zyrtar i gjuhës kombëtare

**LEKSION 5.** Shqipja standarde – histori dhe realitete

**LEKSION 6.** Të drejtat gjuhësore edhe si të drejta të njeriut

**LEKSION 7.** Gjuhët e rrezikuara. Ndërrimi dhe vdekja e gjuhës. A mund të ruhet gjuha?

**LEKSION 8.** Gjuha, raca dhe etnia

**LEKSION 9.** Gjuha, njohja dhe kultura

**LEKSION 10.** Gjuha dhe gjinia

**LEKSION 11.** Shqipja si një gjuhë i.e. dhe tezat për prejardhjen e saj

**LEKSION 12.** Vendi dhe koha e formimit të gjuhës shqipe

**LEKSION 13.** Marrëdhëniet e shqipes dhe të “nënës” së saj me gjuhë të tjera

**LEKSION 14.** Emërtimi i gjuhës shqipe ndër shekuj

**LEKSION 15.** Shqipja si një gjuhë ballkanike

## **FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT**

### **FREKUENTIMI:**

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

### **KONTROLLI I VAZHDUESHËM:**

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

### **DETYRA E KURSIT:**

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

### **KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:**

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

40 % e notës përfundimtare

## **DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN**

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

## **LITERATURA:**

**AHEARN**, Laura (2012) *Living language, An Introduction to Linguistic Anthropology*, Willey-Blackwell

**CABEJ**, Eqrem (1960) *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe (Fonetika historike e shqipes)*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i Historisë e i Filologjisë, Katedra e gjuhës shqipe, Tiranë

**DEMIRAJ**, Shaban (1989) *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë

**JORGAQI**, Kristina (2008) *Sportel i hapur i shqipes*, Ombra GVG, Tiranë

**SHKURTAJ**, Gjovalin (2001) *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë

**WRIGHT**, Sue (2004) *Language policy and language planning (From nationalism to globalization)*, Palgrave Macmillan, New York *Sociolinguistics*, The Hague: Mouton